



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 810/2 Prot.

Tiranë, më 13. 06. 2022

V E N D I M

Nr. 119, datë 13. 06. 2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 85, datë 31.05.2022, të paraqitur nga A. J., kundër Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër¹, në të cilën pretendohet diskriminim për “çdo shkak tjetër²”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja A. J., ka parashtruar se, mban pozicionin e punës “Specialiste me kontratë të përkohshme”, në Drejtorinë Vendore të ASHK-së Shkodër, prej më shumë se 3 vitesh.

Sipas ankueses, me datë 22.04.2022 është zhvilluar një mbledhje “online” në të gjitha Drejtoritë Vendore të ASHK-së, në rang vendi, ku është vendosur që për 4 (katër) punonjës konkretisht: ankuesen dhe punonjësit F. Z., U. L. dhe A. L., të merren masa disiplinore. Për punonjësit F. Z., U. L. dhe A. L., është vlerësuar të merret masa disiplinore “Largim nga detyra”, ndërsa për ankuesen masa disiplinore “Vërejtje me shkrim”.

Më tej ankuesja thekson ndër të tjera se: “...më datë 09.05.2022, më është komunikuar shkresa me lëndë “Njoftim mbi ecurinë e marrëdhënieve të punës”, ku me datë 16.05.2022, ora 12:00 duhet të paraqitem pranë Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të ASHK-së për kryerjen

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën ASHK Shkodër.

² Pa përcaktuar një shkak apo cilësi.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

e procedurës së bisedimeve për ecurinë e marrëdhënieve të punës. Diskriminimi qëndron në faktin që drejtoresha ka abuzuar me detyrën duke privilegjuar kë ka dëshirë dhe diskriminuar figurën, personalitetin, dinjitetin, profesionalizmin tim. Në qoftë se nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK Tiranë është urdhëruar që të merren masa sipas e-mailit dhe kjo drejtoreshë ka ndryshuar dhe shtrembëruar masat duke vënë masa të ndryshme sipas oreksit dhe interesit të saj që ka me punonjësit në fjalë.

Diskriminimi tek unë qëndron edhe në faktin se unë paguhem sipas kategorisë IV-b, ndërsa punonjësit e tjerë të po të njëjtit pozicion paguhen sipas kategorisë IV-a.

Bazuar në shkresën e Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 397/13 prot., datë 17.09.2021 e administruar pranë Drejtorisë Vendore të ASHK Shkodër me nr. 6038 prot., datë 21.09.2021 i është drejtuar drejtorit F. D. duke i rekomanduar që Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së të marrë masa për planifikimin e saktë të numrit të punonjësve në përputhje me ngarkesën e punës dhe të rishikojë lidhjen apo ndërprerjen e kontratave definitive për punonjësit provizor me mbi 3 vite pune, në zbatim të Kodit të Punës, ku këto masa nuk janë ndërmarrë asnjëherë.

Unë jam punonjëse me kontratë të përkohshme dhe në këtë institucion kam plotë 3 vite e 8 muaj punë, bile përveç normave ditore që i kam zbatuar me korrektësinë maksimale, nuk kam kryer ndonjëherë shkelje dhe emri im nuk rezulton në asnjë kontroll të kryer as nga KLSH dhe as nga organe të tjera audituese. Kam zbatuar maksimalisht të gjitha urdhrat, udhëzimet e titullarëve.

Znj. L. B. (me detyrë Drejtore e ASHK Shkodër), me datë 02.05.2022 është paraqitur në detyrë dhe me datë 04.05.2022 ka përpiluar propozimin për largim nga puna me nr. 4571 prot., datë 04.05.2022.

Lind pyetja: Sa e aftë është kjo drejtoreshë që për 2 ditë arrin të vlerësojë aftësitë, kapacitetin, profesionalizmin tim?

Atëherë rezulton se më ka paragjykuar sepse për 2 ditë asnjë titullar nuk është i aftë të vlerësojë punën e një punonjësi e aq më tepër të bëjë akuza fallso që ka shkelur dispozita ligjore, nënligjore, rregullore, urdhra etj., siç citohet në shkresën me lëndë “Propozim për masë disiplinore “Largim nga puna” me nr. 4571 prot., datë 04.05.2022.

Këtu shihet qartë diskriminimi, dhunimi, cënimi që është kryer kundrejt meje dhe të drejtave të mia. E para nga ana e titullares më është ndryshuar masa nga “Vërejtje me shkrim” në “Largim nga puna” sipas interesave personale të punëdhënësit duke u cënuar dinjiteti, personaliteti, aftësitë dhe të drejtat e mia.

Së dyti, janë kryer shpifje në emrin tim ku figura ime rezulton e pastër dhe emri im siç u shpreha më lart nuk rezulton në asnjë organ auditues, KLSH, Prokurori apo Gjykatë duke u cënuar dinjiteti im padrejtësisht.

Së treti, kam punuar maksimalisht më shumë se të gjithë dhe i kam të provuara dhe të dokumentuara që për periudhën janar-prill 2022, kam trajtuar 853 (tetëqind e pesëdhjetë e tre) praktika qytetarësh, dhe për periudhën gusht 2021-prill 2022 kam trajtuar 1669 (njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) praktika duke respektuar maksimalisht urdhrin e titullarit B. T., me nr. 2, datë 07.01.2022, ku në faqen e 3-të citohet norma javore, urdhrat e brendshëm me nr. 198, dt. 27.10.2021 dhe urdhrin e brendshëm me nr. 78, datë 24.05.2021.

Sqaroj se në muajin dhjetor 2021 kam qenë me leje të zakonshme te miratura nga titullari i mëparshëm F. D. (dokumentacioni është nxjerrë nga protokoll i ASHK Shkodër me Nr. 5146 prot., datë 13.05.2022).

Në kontratën individuale të punës në nenin 9, pika 9.3 citohet "punëdhënësi ka detyrimin të respektojë dhe të mbrojë në raportet e punës personalitetin e punëmarrësit", ku në rastin tim është cënuar dhe dhunuar personaliteti im".

Në përfundim, ankuesja kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit nga ana e ASHK Shkodër pa përcaktuar një shkak diskriminimi konkret.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues.

- Për këtë arsye, me e-mail-in datë 06.06.2022 i është kërkuar ankuses të sqarojë shkakun e pretenduar dhe situatën diskriminuese.

Në përgjigje, ankuesja me anë të e-mail-it datë 07.06.2022, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndër të tjera se: *"...Në institucionin tonë me datë 22.04.2022 si edhe në të gjitha drejtoritë vendore të ASHK është dërguar një e-mail ku janë marrë disa masa. Në 4 (katër) emra punonjësish që janë dhënë për Shkodrën, unë jam vlerësuar me "Vërejtje me shkrim" e 3 (tre) të tjerët me "Largim nga puna". Drejtoresha e sapoardhur në detyrë (1 javë që ishte emëruar) ka privilegjuar 2 (dy) punonjës që ishin me largim konkretisht F. Z. dhe U. L. ku për këto 2 (dy) ishte ndërmarrë masa "Largim nga puna" nga mbledhja e zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK Tiranë, duke i "shpëtuar" të dy me "vërejtje me shkrim", dhe për mua së bashku me punonjësën A. L. u dërgua masa "Largim nga puna" nga ana e Drejtoreshës së Shkodrës, L. B.*

Pra, masat janë ndryshuar nga ana e drejtoreshës sipas oreksit, dëshirës së saj, miqësive, privilegjimeve etj., ndërkohë që 3 (tre) punonjësit e tjerë ishin për largim, në fund shpëtuan të 3 dhe unë që isha me "Vërejtje me shkrim" unë u largova.

Pra, ky është diskriminim i hapur dhe evidentohet qartë. Unë diskriminohem në personalitet, në dinjitet, cënohen të drejtat e mia, profesionalizmi im, ndërkohë që kisha punuar më shumë nga të gjithë dhe i kam të gjitha evidentuara unë baltosem sikur kam shkelur x urdhër, x rregullore, x urdhra ligjore e nënligjore dhe asnjë i bashkangjitur nga ana e drejtoreshës.

Pra akuzohem pa fakte dhe prova sepse përpara se të bëhet një akuzë duhet të paraqiten provat mbi të cilat mbështeten akuzat.

Personi F. Z. ishte me kontratë të përkohshme siç isha unë, ndërkohë 2 (dy) punonjëset e tjera A. L. dhe U. L. janë me kontratë të pacaktuar.

Të 3 punonjësit e lartpërmendur kanë patur masa disiplinore të mëparshme në fuqi dhe madje njëra kishte edhe masë për largim edhe 2 vërejtje dhe është mbajtur në detyrë, për shkak të miqësive që ka.

Për masën është ndërmarrë ndaj meje "urdhër nr. 2118, datë 19.05.2022" për zgjidhjen e kontratës së punës së A. J. me motivacionin "Mosrespektimin e afateve në mënyrë të përsëritur

në kryerjen e shërbimeve kadastrale", është shkelur neni 64 i ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" ku për raste të tilla ligji e parashikon vendosjen e gjobave e jo largim nga detyra.

Po këtu shihet qartë tendenca e drejtoreshës L. B. për të bërë ligjin, për të shkelur çfarëdolloj ligji, sepse ka ardh në detyrë me qëllime e synime për të larguar njerëz nga puna, për të privilegjuar ata që ajo do dhe që i kryejnë dosjet e saj.

Ata që nuk binden ose shkojnë në burg ose hiqen nga detyra si në rastin tim që jam larguar për një motiv qesharak."

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, përcaktohet se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".

Diskriminimi përkufizohet nga ligji "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar⁴, në nenin 3/1, si: "Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi".

Në nenin 12, pikat 1, gërma c), të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: "Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: 1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;...".

Në vijim të ndjekjes së procedurave ligjore, Komisioneri reflekton mbi vlefshmërinë ligjore dhe të provuar, të shkakut të diskriminimit. Në përfundim, vërteton duke analizuar provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, nëse ka lidhje shkakësore ndërmjet qendrimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit ankuesi është ekspozuar, me shkakun e diskriminimit të pretenduar.

⁴ Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh⁵. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh⁶.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “*çdo shkak tjetër*”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike të tij.

Sa i takon pretendimit të saj për diskriminim për “*çdo shkak tjetër*”, i pa dokumentuar dhe i aprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvehte.

⁵ Neni 1, i ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar citon se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.*”

⁶ Neni 14, I KEDNJ-së: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”.

Për sa më sipër, shkak i diskriminimit përbën një element kyç në hetimin administrativ të Komisionerit, si dhe duhet vërtetuar me prova të mbështetura në fakte konkrete. Shkak i diskriminimit në vetvete lidhet me një karakteristikë personale të ankuesit, e cila përbën pikënisje për reagimin e padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë të punëdhënësit ndaj tij. Ankuesja ka vënë në dukje se është diskriminuar për sa i përket, procedurave të ndjekura gjatë procesit disiplinor në raport me punonjës të tjerë, por nuk ka identifikuar asnjë shkak apo cilësi personale të saj.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesja nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “...është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “b” të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 85 regj., datë 31.05.2022, të paraqitur nga A. J., kundër Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër, pasi është e papajtueshme me dispozitat ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Çdo shkak tjetër)
(Fusha: Punësim)